



Adresa : Rruga "Abdyl Frasheri",
Ndertesa nr.8 Shkalla C , kati 2 Tirane

Nr.81 Prot. Tiranë, më 27 .02.2020

LËNDA: TeleDoc Albania ndihmon Shqipërinë dhe Europën

DREJTUAR: KRYETARIT TË QARKUT

Të nderuar!

TeleDoc Albania vë në dispozicion aplikacionin TeleDoc i cili krijon mundësinë për të komunikuar 24/7 me mjekë specialistë.

TeleDoc Albania me seli në Tiranë e cila operon prej vitit të kaluar si pjesë e TeleDoc Global një start-up austriak vë në dispozicion mjekët e saj për rajonet si Shqipëri ,Itali, Europë

Duke marrë shkas nga situata e krijuar gjatë ditëve të fundit dhe nga njoftimet e vazhdueshme të institucioneve përkatëse , sugjerohet që personat që kanë pasur kontakt me persona të infektuar nga Coronavirus dhe që dyshojnë se mund të jenë prekur , para se të shkojnë në spital mund të informohen këshillohen me mjekun paraprakisht nëpërmjet telefonit Për këtë arsye TeleDoc Albania ka hapur një linje të dedikuar me shërbim audio dhe video papagesë për të gjitha rajonet si Shqipëri ,Itali, Europë.Me anë të kësaj linje të dedikuar cdo person mund të komunikojë me audio dhe video pa pagesë me mjekun pa qenë e nevojshme të paraqitet në spital.Për ta bërë të mundur këtë, nevojitet të shkarkohet aplikacioni TeleDoc-App në telefon, të cilin e gjeni në website www.TeleDoc.global

Vetëm me një klikim mjekët janë në dispozicionin tuaj. Për momentin ofrohet shërbim në gjuhët: shqipe italiane, angleze dhe gjermane.Nëse do të shihet e nevojshme TeleDoc Albania do të shtrijë më tej shërbimin e saj në rajone të tjera të Europës.TeleDoc Albania me mjekët e saj ka dhënë mbështjetjen e saj duke ofruar shërbim pa pagesë gjatë tërmetit në Durres.

Drejtori i Përgjithshëm i Kompanisë TeleDoc , **Christian Brandstetter** e sheh këtë si një kontribut të teknologjisë moderne të së ardhmes në ndihmë të situatës aktuale.

Kontakt për shtypin :

Besa Mulita

Tele Doc Albania ,Tirana Tel: +35569898445 besamulita@teledoc.al

TeleDoc – Mjeku juaj Kudo dhe Kurdo

TeleDoc është një rrjet mjekësh të licencuar që ju ofron këshillim të vazhdueshëm nëpërmjet telefonit dhe video- telefonatave 24 orë në ditë, 365 ditë të vitit.

24 orë në 365 ditë të vitit, nëpërmjet telefonates ose Video-telefonatës.

TeleDoc është një zgjidhje telemjekësore, tërësisht e re, që do të ndryshojë mënyrën se si ju aksesoni shërbimet mjekësore nëpërmjet teknologjisë moderne